



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Nr. Prot. _____ Dt _____

RAPORT I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR VITIN FISKAL 2018

Janar/2019

P Ë R M B A T J A

1. Hyrje.....	3
2. Analiza e Buxhetit.....	4
3. Buxheti i planifikuar dhe ndryshimet gjatë vitit fiskal 2018.....	6
4. Realizim i buxhetit për vitin fiskal.....	9
4.1 Paga dhe mëditje	10
4.2 Mallra dhe shërbime.....	13
4.3 Shpenzime komunale.....	16
4.4 Subvencione dhe transfere.....	17
4.5 Investime kapitale.....	18
5. Të hyrat vetanake.....	20

1. HYRJE

Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr .03/L-048, neni 44 pika 44.4 dhe neni 46 pika 46.1 lidhur me hartimin e raportit vjetor fiskal, Statutin e Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës neni 181 dhe 180 lidhur me buxhetin e aprovuar dhe procedurat buxhetore për vitin fiskal 2018 nga Këshilli Drejtues, neni 28 pika 1.9 dhe 1.10 lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e rektorit të dala nga Statuti i përkohshëm i Universitetit të Mitrovicës, rektori paraqet raportin mbi planifikimin dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin fiskal 2018.

Buxhetin e Universitetit të Mitrovicës e karakterizon procesi i konsultimeve dhe sistemimi i kërkesave të administratës qendrore dhe njërive akademike të harmonizuara me kufijtë final buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave. Kërkesat janë të harmonizuara me njësitë akademike duke konsideruar që aktivitetet të ndërlidhen me implementimin e përgjegjësiave që janë përcaktuar me fushëveprimin e institucionit të Arsimit të Lartë në Kosovë dhe Planin strategjik për Universitetin e Mitrovicës për vitet 2018/2021.

Gjatë vitit fiskal 2018 në bashkëveprim me menaxhmentin e universitetit dhe bartësve të njërive akademike, vëmendje e posaçme ju kushtua hartimit të programit për menaxhimin financiar. Procesi i menaxhimit financiar, realizimi i objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara sipas Planit Strategjik për UMIB për vitin e parë(2018) të planifikimit është reflektuar në administrim të drejtë dhe racionalizim të shpenzimeve.

Raporti përmban analizë përmbledhëse të aktiviteteve të realizuar sipas objektivave të planifikuara dhe të pasqyruara në Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2018/2020, dhe vendimeve nga niveli qendror (MF, MASHT). Plani i punës, rekomandimet e Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit ishin të varura nga masa buxhetore dhe kufijtë final të përcaktuar sipas Qarkoreve finale të lëshuara nga Ministria e Financave për UMIB.

Raporti pasqyron realizimin e shpenzimeve dhe të hyrave duke specifikuar dhe komentuar se në çmasë janë realizuar objektivat dhe aktivitetet të pasqyruara në planet të punës për administratë dhe njësi akademike.

Pasqyrat financiare për periudhën raportuese janë të bazuara në dokumentet:

1. Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë-pasqyrimi i pasqyrave financiare;
2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020;
3. Ligji mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës nr. 06/L-20 për vitin 2018;
4. Buxheti për vitin 2018 për Universitetin e Mitrovicës;
5. Vendimi për kursim të shpenzimeve dhe akordim të mjeteve shtesë nga Qeveria e Kosovës;
6. Vendimet mbi ndryshime të buxhetit nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
7. Statuti i përkohshëm i Universitetit të Mitrovicës;
8. Vendimet nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës;
9. Planin e rrjedhës së parasë të bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2018 për Universitetin e Mitrovicës.

Pasqyrat financiare janë të harmonizuara me të dhënat e sistemuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës(SIMFK).

2. ANALIZA E BUXHETIT

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike i bazuar në kufijtë final të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për Universitetin e Mitrovicës, pasqyron mundësinë e realizimit të aktiviteteve të cilat ndërlidhen me fushëveprimin e Universiteteve Publike dhe Planit Strategjik të Arsimit të Lartë të Kosovës për vitet 2017-2021.

Kufijtë final të strukturuar nëpër kategori ekonomike në masë të madhe në aspektin financiar nuk ndërlidhen me përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara sipas Kornizës Afatmesme e Shpenzimeve për vitet 2018-2020 për UMIB dhe Planin Strategjik për vitet 2018/2021 për Universitetin e Mitrovicës.

Mungesa e mjeteve buxhetore në të gjitha kategoritë ekonomike bëri që menaxhmenti të përcaktoj prioritete të reja duke hartuar programin për racionalizim të shpenzimeve. Masa buxhetore ndikoi në realizim të aktiviteteve dhe nivelin e shërbimeve për student.

Sfiduese për këtë vit fiskal ishte: organizimi për implementim të vendimit për hapje të kampusit të ri universitar dhe procesi i rekrutimit të personelit të ri akademik të rregullt dhe të angazhuar.

Pasqyrimi i specifikave dhe vështirësitë të cilat ishin të trashëguara nga viti fiskal 2017, vendimet dhe kërkesat shtesë të drejtuara institucioneve relevante të vendosjes lidhur me minusin në paga janë treguar si produktive, me faktin se Qeveria e Kosovës aprovoi kërkesën për akordim të mjeteve shtesë duke mundësuar që të finalizohet procesi i rekrutimit dhe përmbushja e obligimeve financiare për këtë kategori ekonomike.

Hartimi dhe implementimi i programit për racionalizim të shpenzimeve në kategoritë ekonomike: mallra dhe shërbimet dhe shpenzime komunale, mundësoi që të bëhet ristrukturim ndërmjet zërave shpenzues. Mjetet janë destinuar në zëra të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në avancim të punës dhe krijim të kushteve më të mira për studentët e Universitetit të Mitrovicës.

Buxheti final për vitin 2018 ishte **3.154.746.05** euro që në krahasim me buxhetin e vitit 2017 është më i lartë për 50.886.16 euro ose me indeks prej 1.64% (3.103.859.89).

Buxheti i aprovuar është realizuar në shumë prej **2.890.272.91** euro ose me indeks prej 91.62% që në krahasim me vitin 2017 është më i ulët për 7.24%. Në indeks të realizimit ndikuan: vendimet e vonuara për ridestitim të mjeteve nga Qeveria dhe MF, procedurat e stërzgjatura të ligjit mbi prokurim dhe harmonizimi i shpenzimeve komunale si rrjedhojë e prolongimit të inaugurimit të kampusit të ri universitar.


Për periudhën 5 vjeçare të funksionimit të Universitetit të Mitrovicës mund të konstatojmë se në kontinuitet është ngritë niveli i menaxhimit të financave e cila ndërlidhet me planifikim, mbikëqyrjen dhe realizim të drejtë të buxhetit.

Menaxhimi financiar dhe sukseset e arritura janë ngushtë të lidhura me kërkesën për pavarësim financiar duke konsideruar se UMIB-i finalizoi strukturimin dhe ngritjen profesionale të përgjegjësve në fushën e menaxhimit të financave publike. Menaxhimi financiar dhe shpenzimi i drejtë i parasë publike është pasqyruar edhe në auditimin e jashtëm i kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit. Objekt i auditimit ishin aktivitetet dhe shpenzimet e realizuara në kategoritë ekonomike: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime dhe procedurat e realizimit të investimeve kapitale. ZKA për auditimin e kryer nuk ka dhënë vërejtje lidhur me aktivitetet që ishin bazë e auditimit.

Nga pasqyrat e poshtë shënuara vërehet se në kontinuitet është ngritë masa buxhetore dhe paralele me këtë edhe indeksi i realizimit që ishte si rrjedhojë e qasjes së re të menaxhimit dhe aplikimit të punës ekipe.

Buxheti i planifikuar për katër vitet e fundit të funksionimit të Universitetit të Mitrovicës i strukturuar nëpër kategori ekonomike.


Kategoritë ekonomike	Buxheti final për vitin 2015	Buxheti final për vitin 2016	Buxheti final për vitin 2017	Buxheti final për vitin 2018	Indeksi i rritjes së buxhetit për vitin 2016 në krahasim me 2015	Indeksi i rritjes së buxhetit për vitin 2017 në krahasim me 2016	Indeksi i rritjes së buxhetit për vitin 2018 në krahasim me 2017
1	2	3	4	5	6	7	8
Paga & Mëditje	1.287.637.75	2.052.580.25	2.350.264.21	2.376.887.75	159.40	114.50	101.13
Mallra&Shërbime	301.119.43	316.339.00	332.899.00	371.339.00	105.05	105.23	111.54
Shpenzime komunale	64.998.25	50.000.00	54.340.00	160.200.00	(23.08)	108.68	294.81
Subvencione	10.000.00	10.000.00	10.000.00	30.000.00			300.00
Kapitalet	18.376.84	286.109.96	356.356.68	216.319.30	1.556.90	124.55	(60.70)
Total	1.682.132.27	2.715.029.21	3.103.859.89	3.154.746.05	161.40	114.32	101.63



Pasqyra e realizimit dhe indeksi i krahasimit për katër vitet e fundit të funksionimit të UMIB-it

Kategoritë ekonomike	Realizimi i buxhetit për vitin 2015	Realizimi i buxhetit për vitin 2016	Realizimi i buxhetit për vitin 2017	Realizimi i buxhetit për vitin 2018	Indeksi i realizimit për vitin 2015	Indeksi i realizimit për vitin 2016	Indeksi i realizimit për vitin 2017	Indeksi i realizimit për vitin 2018
	1	2	3	4	5	6	7	8
Paga & Mëditje	1.287.637.7	2.050.262.25	2.350.264.21	2.347.616.75	100	100.00	100.00	98.77
Mallra&Shërbime	257.722.96	307.242.83	300160.77	281.639.44	85.59	97.12	90.16	75.84
Shpenzime komunale	64.708.06	49.757.78	53.848.97	113.188.10	99.55	99.52	99.10	70.65
Subvencione	10.000.00	9.945.00	8.575.00	29.999.75	100	99.45	85.75	100
Kapitalet	18.376.84	286.106.06	355.857.78	117.827.37	100	100.00	99.86	54.47
Total	1.638.445.6	2.703.313.92	3.068.706.73	2.890.272.91	97.40	99.65	98.86	91.62

Indeksi i realizimit i strukturuar nëpër kategori ekonomike




3. BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE NDRYSHIMET GJATË VITIT FISKAL 2018

3.1 Buxheti për Universitetin e Mitrovicës i bazuar në Ligjin për Buxhetin të Republikës së Kosovës nr. 06/L-20

Buxheti për UMIB i aprovuar në Janar/2018 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr. 06/L-20 ishte **2.905.398.00** euro që në krahasim me buxhetin e vitit 2017 është më i ulët për 63.000.44 euro ose me indeks prej 2.24% %. Buxheti sipas kufijve final është harmonizuar nëpër kategori ekonomike. Në kategoritë ekonomike: paga dhe mëditje, shpenzime komunale dhe subvencione kemi rritje të lehtë kurse tek investimet kapitale kemi zvogëlim për 40.20%.

KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti i aprovuar në janar sipas Ligjit mbi ndarjen buxhetore për vitin 2018/Janar 2018
1	2
1. PAGA DHE MËDITJE	2.042.359.00
2. MALLRA DHE SHËRBIME	316.339.00
3. SHPENZIME KOMUNALE	215.000.00
4. SUBVENCIONE	30.000.00
5. INVESTIME KAPITALE	301.500.00
6. GJITHSEJ	2.905.398.00

Buxheti i aprovuar në janar sipas Ligjit mbi ndarjen buxhetore për vitin 2018



3.2. Buxheti final i bazuar në vendimet e Qeverisë për akordim të buxhetit shtesë dhe vendimin e MASHT-it për kursim të mjeteve buxhetore.

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës përmes raporteve periodike të shpenzimeve është njoftuar lidhur me performancën e realizimit të shpenzimeve dhe mungesën e mjeteve buxhetore në disa kategori ekonomike. Kërkesat e shtuara dhe pasqyrimi permanent për gjendjen e vështirë në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje, bëri që Qeveria e Kosovës në muajt tetor/dhjetor të aprovoi kërkesën për buxhet shtesë duke akorduar 302.992.50 euro për të mbuluar minusin e planifikuar në paga.


Qeveria e Kosovës bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë në të gjitha organizatat buxhetore ka parashtruar kërkesë për kursim të mjeteve në të gjitha kategoritë ekonomike. UMIB, si nënprogram i MASHT ka pasqyruar kursimet për investime kapitale në shumë prej 183.672.23 euro. MF aprovoi kërkesën për kursim në shumë prej 85.065.00 euro. Në të njëjtën kohë është aprovuar, edhe pse me vonesë, kërkesa për ridestinim të mjeteve në shumë prej 55.000.00. Ridestini është realizuar nga kategoria ekonomike shpenzime komunale në mallra dhe shërbime.

Buxheti final për Universitetin e Mitrovicës bazuar me këto ndryshime është **3.154.746.05** euro që është më i lartë për 249.438.05 në krahasim me buxhetin e aprovuar në Janar të vitit 2018 (**2.905.398.00**). Burimet e financimet janë planifikuar nga Buxheti i Kosovës në shumë prej **3.005.220.05** euro, 100.015.50 nga të hyrat vetanake të alokuara gjatë vitit 2018 dhe të hyrat e bartura nga viti 2017 në shumë prej 49.510.50 euro.

Buxheti mund të karakterizohet si buxhet shpenzues me faktin se afër 80% të mjeteve të planifikuara janë dedikuar për paga, shpenzime kontraktuese dhe komunale. Buxheti i mbetur prej 20% ishte i dedikuar për shërbime që janë direkt të lidhura me ngritjen e nivelit dhe kualitetit mësimdhënës (botime shkencore, shërbime intelektuale dhe këshillëdhënëse, udhëtime studimore, pajisje tjera etj).

Buxheti final i bazuar në kursime dhe vendimet e Qeverisë për buxhet shtesë:

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti final i bazuar në reduktime dhe vendimet për buxhet shtesë	Burimet e financimit		
			Buxheti i Kosovës	Të hyrat vetanake të alokuara 2018	Të hyrat vetaake të bartura nga 2017
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.376.887.75	2.227.361.75	100.015.50	49.510.50
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	371.339.00	371.339.00		
3.	SHPENZIME KOMUNALE	160.200.00	160.200.00		
4.	SUBVENCIONE	30.000.00	30.000.00		
5.	INVESTIME KAPITALE	216.319.30	216.319.30		
6.	GJITHSEJ	3.154.746.05	3.005.220.05	100.015.50	49.510.50



Paga dhe mëditje – për vitin fiskal 2018 masa buxhetore e planifikuar për përmbushjen e obligimeve për paga është 2.376.887.75 euro që është për 26.623.54 euro më e lartë se buxheti i realizuar për paga në vitin 2017.

Mallra dhe shërbime – Masa buxhetore për këtë kategori është rritur për 55.000.00 euro ose me indeks prej 17.38% në krahasim me buxhetin e aprovuar për vitin fiskal 2018.

Shpenzime Komunale – shpenzimet komunale janë 160.200 euro që janë me të ulëta për 55.000.00 euro ose për 25.56 % në krahasim me planifikim të vitit në janar 2018.

Subvencionet – mjetet e planifikuara janë në shumë prej 30.000.00 euro dhe janë më të larta për 20.000.00 euro ose me indeks prej 300% me pjesëmarrje 1.32% në strukturën e buxhetit të ndryshuar.

Investime kapitale – Investimet kapitale janë në shumë prej 216.319.30 euro që në krahasim me mjetet e planifikuara janë zvogëluar për 85.180.70 euro në krahasim me buxhetin e aprovuar në janar/2018 ose me indeks prej 28.26 %.

4. REALIZIMI I BUXHETIT

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit, përmes pasqyrave financiare, pasqyron si është bërë menaxhimi i parasë publike duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikim, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuar në kategori ekonomike.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar realizimi i buxhetit i krahasuar me burime, alokim, zotim, realizim dhe indeks të realizimit:

Kategoritë ekonomike	Buxheti FINAL për 2018	Alokimi	Mjetet shpenzuara	Zotimet/ obligimet pa shlyera	Shpenzimet e planifikuara	Mjetet e pashfrytez uara	Mjetet e angazhuara në %	Shpenzimi i buxhetit në %
1	2	3	4	5	6=4+5	7=3-6	8=6/2*100	9=4/3*100
Paga & Mëditje	2.376.887.75	2.376.887.75	2.347.618.25		2.347.618.25	38.998.50	98.36	98.77
Mallra&Shërbime	371.339.00	371.339.00	281.639.44	89.640.10	371.279.54	59.46	100.00	75.84
Shpenzime komunale	160.200.00	160.200.00	113.188.10	0.00	113.188.10	47.011.90	71.00	70.65
Subvencione	30.000.00	30.000.00	29.999.75	0.25	30.000.00	0.00	100.00	100
Kapitalet	216.319.30	216.319.30	117.827.37	98.356.63	216.184.00	135.30	100.00	54.47
Total	3.154.746.05	3.154.746.05	2.890.272.91	187.996.98	3.078.269.89	86.205.16	97.57	91.62


Pagat dhe mëditjet - janë alokuar **2.376.887.75** euro për përmbushjen e obligimeve për paga të personelit akademik të rregullt, të angazhuar dhe personelit administrativ. Për periudhën raportuese janë realizuar **2.347.618.25** euro ose me indeks të realizimit prej 98.77 %.

Mallrat dhe shërbimet – janë alokuar 371.339.00 euro dhe janë realizuar 281.639.44 euro ose me indeks prej 75.84 % të mjeteve të alokuara.

Shpenzimet komunale – janë alokuar 160.200.00 euro, janë realizuar 113.188.10 ose me indeks prej 70.65% në krahasim me mjetet e e planifikuara.

Subvencionet dhe transferet – janë alokuar 30.000.00 euro, janë realizuar 29.999.75 ose me indeks prej 100.00 % në krahasim me mjetet e planifikuara.

Investimet kapitale – sipas planit të rrjedhës së parasë janë alokuar mjete në shumë prej 216.319.30 dhe janë realizuar obligimet në shumë prej 117.827.37 euro ose me indeks prej 54.47% në krahasim me mjetet e alokuara.



Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike

4.1 PAGA DHE MËDITJE

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për kategorinë ekonomike dhe vendimit të Qeverisë për ndarje të mjeteve shtesë për paga ishte 2.376.887.75 euro. Mjetet ishin të planifikuara për përmbushjen e obligimeve ndaj 196 punëtorëve (129 personel akademik dhe 67 personel administrativ). Buxheti i lejuar për paga dhe mëditje nuk ishte i harmonizuar me numrin e planifikuar sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2018. Numri i lejuar dhe gjendja aktuale ka determinuar që Universiteti i Mitrovicës në kontinuitet përmes kërkesave shtesë të aktualizon gjendjen alarmante financiare për këtë kategori, duke dhënë arsyshmërinë dhe propozuar versionet e kërkesave shtesë për të dalë ose zbutë gjendjen e vështirë financiare. Sfiduese ishte vendimi për rekrutimin e personelit akademik të rregullt dhe të angazhuar i cili ndërlidhet me qëndrueshmërinë dhe akreditimin e programeve të reja. I tërë procesi i rekrutimit është finalizuar me ndarjen e mjeteve shtesë nga Qeveria e Kosovës për të përmbush obligimet ndaj personelit akademik të rregullt dhe të angazhuar. Përkundër mjeteve të ndara, UMIB-i ishte në pamundësi financiare që të përmbush planin e aprovuar të personelit sidomos në administratë.

Struktura e personelit të UMIB-it bazuar në gjendjen aktuale për paga të dhjetorit.

Nr	Emërtimi i personelit të UMIB-it	Struktura e planifikuar sipas Ligjit mbi Buxhetin dhe planit të personelit për vitin 2018	Personeli aktual akademik dhe administrativ në sistemin e pagave	Vendet e lira të bazuara në numrin e lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2018
	1	2	3	4=2-3
1.	Personel të rregullt akademik	129	94	35
2.	Personeli akademik i angazhuar		53(21)	
3.	Personel administrativ	67	49	18
4.	gjithsej	196	196	53

Menaxhmenti bazuar në objektivat për organizimin e vitit të ri akademik 2018/2019 duke e ndërlidhë me numri e lejuar sipas ligjit, shpall konkurs për pranimin e personelit akademik të rregullt dhe të angazhuar. Qëllimi ishte që të finalizohen objektivat për funksionalizim të programeve të akredituara por edhe të krijohen kushte për akreditimin e ri të programeve në vitin 2019. Universiteti i Mitrovicës bazuar në numri e lejuar ka edhe 53 vende të lira pune dhe atë : 35 personel akademik dhe 18 administrativ.

Nga të dhënat e lartë cekura pasqyrohet ndërlidhja dhe mos harmonizimi i buxhetit të planifikuar me numrin e lejuar sipas ligjit mbi buxhetin për vitin 2018. Buxheti aktual me ndryshimet e aprovuara mbulon vetëm 164 (duke llogaritur numrin e të angazhuarve/përpjesëtimi 1:2.5) të punësuar duke pamundësuar edhe rekrutimin e 53 vendeve të lira. Mos harmonizimi i buxhetit dhe numrit të personelit bartet që nga viti 2015, kur është bërë edhe bartja e dy njësive akademike në Universitetin e Mitrovicës.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar planifikimi, alokimi dhe realizimin i pagave për UMIB.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Paga e planifikuar bazuar në buxhetin final	alokimi e mjeteve	Pagat e realizuara për 2018	Indeksi i realizimit
		2	3	4	5=4/3*100
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.376.887.75	2.376.887.75	2.347.618.25	98.77%


Struktura e burimeve të mjeteve të planifikuara dhe të realizuara për vitin fiskal 2018.

nr	Emërtimi i burimeve të financimit	Shuma e planifikuar	Alokimi	Realizimi
1.	Nga Buxheti i Kosovës	1.924.369.25	1.924.369.25	1.924.369.25
2.	Nga Qeveria e Kosovës (vendimi për Buxhet shtesë)	302.992.50	302.992.50	302.992.50
3.	Të hyrat vetanake të realizuara për 2018	100.015.50	100.015.00	70.746.00
4.	Të hyrat vetanake të bartura të vitit 2017	49.510.50	49.510.50	49.510.50
5.	Gjithsej burimet 1-4	2.376.887.75	2.376.887.75	2.347.618.25

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar realizimi mujor për paga duke pasqyruar edhe ndarjen e mjeteve për personelin e punësuar në UMIB.

n r	UMI B	Pers. Adm nistr a-tiv	shuma	Pers. Akad-adem.	shuma	Pers. akad/i angazh.	Shuma	Tot.	Shuma
5.	JANAR	47	31.242.65	100	148.027.40	45(3)	2.367.75	192	181.637.80
6.	SHKURT	47	30.460.82	99	160.220.50	46(6)	14.228.55	192	204.919.50
7.	MARS	47	30.045.17	99	155.333.94	46(15)	4.678.00	192	190.057.11
8.	PRILL	47	33.322.98	98	165.200.46	49(34)	13.603.25	194	212.126.69
9.	MAJ	47	31.886.18	98	163.959.12	49(37)	15.679.23	193	211.524.53
10.	QERSHOR	47	30.467.37	98	168.490.40	49(37)	15.876.55	193	214.834.32
11.	KORIK	47	30.149.83	103	148.451.15	44(1)	21.00	194	178.621.83
12.	GUSHT	47	30.665.03	103	163.533.38	44(17)	1807.68	194	196.006.09
13.	SHTATOR	49	29.737.66	103	145.880.74	44		196	175.618.40
14.	TETOR	49	30.260.80	97	138.337.26	44	21.00	190	168.618.65
15.	NËNTOR	49	32.001.65	97	156.220.63	46	7.259.98	192	195.482.26
16.	DHJETOR	49	30.423.23	94	154.780.05	53	32.967.23	196	218.170.55
17.	Gjithsej		370.673.00		1.868.435.03		108.510.22		2.347.618.25


Nga pasqyra e lartë shënuar, vërehet se shuma prej 1.868.435.03 euro është shpërndarë për personelin akademik ose 79.58 % të shumës së shpërndar (2.347.618.25), për personelin akademik të angazhuar janë shpërndarë 108.510.22 euro ose 4.62% dhe për personelin administrativ të strukturuar në administratën qendrore (rektorat) dhe njësitë akademike shuma prej 370.673.00 euro ose 15.78% të shumës së shpërndarë për periudhën raportuese.



Periudha e viteve 2015/2018 karakterizohet me rritje të vazhdueshme të buxhetit për këtë kategori. Buxheti dhe vështirësitë reflektohen në çdo viti fiskal dhe vit akademik. Menaxhmenti përkundër vështirësive financiare ka hartuar programin për menaxhim të buxhetit duke bërë përshtatshmërinë e numri të personelit akademik i cili në asnjë rrethanë nuk ndikoi në zvogëlimin e cilësisë së programeve të akredituara. Përkundrazi performanca e treguar bëri që të rritet interesimi i të rinjve për të studiuar në Universitetin e Mitrovicës.

Pasqyra e mjeteve të realizuara për paga dhe mëditje për periudhën 2015/2018

Kategoritë ekonomike	Realizimi i buxhetit për vitin 2015	Realizimi i buxhetit për vitin 2016	Realizimi i buxhetit për vitin 2017	Realizimi i buxhetit për vitin 2018
Paga & Mëditje	1.287.637.7	2.050.262.25	2.350.264.21	2.347.618.25



4.2. MALLRA DHE SHËRBIME

Masa buxhetore e planifikuar për këtë kategori nuk ishte e mjaftuar për të mbuluar të gjitha aktivitetet e planifikuara për të realizuar mbarëvajtjen dhe funksionalizimin e mirëfilltë të Universiteti të Mitrovicës.

Bazuar në disponshmërinë e mjeteve buxhetore menaxhmenti ishte i obliguar që të hartoj planin mbi racionalizim të shpenzimeve duke definuar qartë prioritetet. Sfiduese për këtë vit buxhetor ishte edhe planifikimi i inaugurimit të kampusit të ri universitar. Masa buxhetore ishte e pa mjaftuar për të funksionalizuar dhe arsyetuar standardet e definuara. Krijimi i kushteve dhe shërbimeve për studentë marrë parasysh disponshmërinë e mjeteve ishte e vështirësuar, me faktin e mungesës së mjeteve për të funksionalizuar sallën e leximit, pajisjen e kabineteve, laboratorëve dhe shpenzimeve tjera me karakter të ngritjes së nivelit mësimdhënës.

Për vitin buxhetor janë planifikuar 316.339.00 euro për të përmbushur aktivitetet e planifikuara sipas programit për racionalizim të shpenzimeve. Planifikimi i inaugurimit të kampusit të ri universitar, krijimi i kushteve sipas standardeve shtyri menaxhmentit që të bëjë harmonizimin e nënkodeve mes kategorive ekonomike. Qëllimi ishte që me kursim të mjeteve të krijohet masa buxhetore e cila do të jetë më se e nevojshme për ngritjen e nivelit për shërbime dhe mësim sa më kualitativ.

Mjetet e kursyera nga kategoria ekonomike shpenzime komunale në shumë prej 55.000.00 janë ridestinuara në këtë kategori. Mjetet janë destinuar për kompletimin e sallës së leximit/bibliotekës me kompjuterë dhe pajisje tjera që do të jenë në shërbim për studentë.

Buxheti për mallra dhe shërbime me ndryshimet e bëra për periudhën raportues ishte 371.339.00 euro, janë alokuar mjete në po të njëjtën shumë. Indeksi i realizimit prej 75.84% mund të konsiderohet i suksesshëm me faktin se MF me vonesë akordoi mjetet prej 55.000.00 euro. Për shkak të procedurave të stërzgjatura të prokurimit ishte e pamundur realizimi/furnizimi për kompjuter andaj edhe shuma prej 55.000.00 u karakterizuan si mjete të pashfrytëzuara duke e ulë indeksin e realizimit për 14.81%. Në indeks të realizimit ndikoi edhe mos furnizimi me kohë i pajisjeve që do të jenë në shërbim të laboratorëve në shumë prej 4.439.50 dhe shuma prej 10.000.00 e dedikuar për transportin e mjeteve themelore të njësive akademike nga objektet e vjetra në laboratorët e kampusit të ri universitar.

Zyra për buxhet dhe financa bazuar në përgjegjësitë ka zotuar mjetet për këtë kategori me indeks prej 100% ose mjetet e angazhuara bazuar në planifikimin e aktiviteteve janë me indeks prej 100% kurse realizimi për shkaqe të lartë përmendura është me indeks prej 75.84%.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi i mjeteve bazuar në ridestininim	Alokimi i mjeteve	Mjetet e shpenzuara	Mjetet pashfrytëzuara	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4	5=3/2*100
1.	MALLRA DHE SHËRBIME	371.339.00	371.339.00	281.639.44	89.640.10	75.84

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar shpenzimet të strukturuar nëpër kode ekonomike, duke bërë krahasime me mjetet e planifikuara sipas ndarjes buxhetore, alokimin e mjeteve dhe realizimin për periudhën raportuese.

KODI EKONOMIK	KATEGORIA EKONOMIKE	BUXHETI PËR VITIN 2018	MJETET E SHPENZUAR A 2018	Indeksi i realizimit
13000	Mallrat dhe shërbimet	371,339.00	281,636.02	75.84
13100	Shpenzimet e udhëtimit	8,000.00	7,825.44	97.81
13130	Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit			
13140	Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	8,000.00	7,165.44	89.56
13142	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jashtë vendit		660	
13300	Shërbimet e telekomunikimit	28,739.00	21,153.12	73.60
13310	Shpenzimet për Internet	5,000.00	127.9	2.55
13320	Shpenzime tjera telefonike - Vala 900	21,600.00	20,075.22	92.94
13330	Shpenzimet postare	500		0
13340	Shpenzimet për përdorim të kabllit optik	1,639.00	950.00	57.96
13400	Shpenzimet për shërbimet	38,500.00	36,977.72	96.04
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	5,000.00	2,785	55.7
13440	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës			
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore			
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	1,000.00		
13450	Shërbime shtypje-jo marketing	5,000.00	2,907.5	58.15
13460	Shërbime tjera kontraktuese	25,000.00	31,075.22	124.30
13470	Shërbimet teknike	2,500.00		
13480	Shpenzimet për anëtarësim		210	
13495	Pagesa për Vendime Gjyqësore			
13500	Blerja e mobilieve dhe pajisjeve më pak se 1000 Euro	75,000.00	32,741.76	43.65
13501	Mobilie		990	
13502	Telefona			
13503	Kompjuterë	55,000.00	9,997.56	18.177
13504	Harduer për teknologji informative			
13505	Makina fotokopjuese			
13506	Pajisje speciale mjekësore			
13507	Pajisje të shërbimit policor	0		
13508	Pajisje trafiku			
13509	Pajisje tjera	20,000.00	21,754.2	108.77
13600	Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	13,500.00	13,129.48	97.25
13610	Furnizime për zyrë	5,000.00	9,631.48	192.62

13620	Furnizim me ushqim dhe pije(spitale, burgje, çerdhe- jo dreka zyrtare)	2,000.00	1,711	85.55
13630	Furnizime mjekësore (organizata shëndetësore,qendrat e mjekësisë familjare)			
13640	Furnizime pastrimi	500.00		
13650	Furnizim me veshmbathje	1.000.00	930	93
13660	Akomodimi (Strehimi I punëtorëve)	1,000.00	857.00	85.7
13670	Municipion dhe armë zjarri			
13655	Furnizim me preparate kimike	4,000.00		
13681	Bllombat			
13700	Derivatet dhe lëndët djegëse	24,000.00	21,390.72	89.12
13710	Vaj			
13720	Naftë për ngrohje qendrore	20,000.00	17,512.81	87.56
13730	Vaj për ngrohje			
13740	Mazut			
13750	Qymyr			
13760	Dru			
13770	Derivate për gjenerator			
13780	Karburant për vetura	4,000.00	3,877.91	96.94
13800	Llogarite e avansit	2,000.00	2,000.00	100
13810	Avans per para te imëta(p.cash)	2,000.00	2,000.00	100
13820	Avans për udhëtime zyrtare			
1395	Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	63,600.00	50,594.42	79.55
13950	Regjistrimi i automjeteve		1,887.02	
13951	Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	3,000.00	100.00	3.33
13952	Taksat komunale e regjistrimit të automjeteve	600	515	85.83
13953	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	60,000.00	48,092.4	80.15
14000	Mirëmbajtja	93,500.00	82,120.36	87.82
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,500.00	2,322	92.88
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	80,000.00	66,229.57	82.78
14040	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	10,000.00	11,585.85	115.85
14050	Mirëmbajtja e mobilieve dhe pajisjeve	1000	1,982.94	198.29
14200	Shpenzimet e marketingut	12,000.00	1,972.00	16.43
14210	Reklammat dhe konkurset	2,000.00	992.00	49.6
14220	Botimet e publikimeve	5,000.00		
14230	Shpenzimet për informim publik	5,000.00	980.00	19.6
14300	Shpenzimet e përfaqësimit	12,000.00	11,731	97.75
14310	Drekat zyrtare	12,000.00	11,731	97.75
14400	Shpenzime për vendime të gjykatave	500	0	
14410	Shpenzime për vendime të gjykatave	500.00		

4.3. SHPENZIMET KOMUNALE

Planifikimi, realizimi i shpenzimeve për vitin 2017, shpenzimet e kalkuluara për objektet e kampusit të ri universitar ishin kritere për planifikim të ri të shpenzimeve komunale për vitin 2018. Arsyeshmëria e planifikimit të shpenzimeve mundësuan që MF të përcaktoi kufijtë e ri final të shpenzimeve.

Buxheti i planifikuar për këtë kategori bazuar në aprovim të kërkesave është 215.200.00 euro e që është më i lartë për 165.200.0 euro në krahasim me mjetet e planifikuara për vitin 2017.

Gjatë periudhës raportuese është aplikuar kërkesa dhe apeli tek njësitë akademike (objektet universitare të vjetra, periudha janar/prill) për racionalizim të shpenzimeve që vërehet edhe në zvogëlim të shpenzimeve për të gjitha kodet ekonomike të kategorisë së shpenzimeve. Prolongimi i inaugurimit të kampusit të ri universitar mundësoi që të kursehen mjetet buxhetore. Kursimi i mjeteve bëri që menaxhmenti të sjell vendim për transfer/ridestinim të mjeteve në shumë prej 55.000.00 euro në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.

Buxheti final bazuar në kursimet ishte 160.200.00 euro, janë alokuar mjete në shumë prej 160.200.00 euro duke shpenzuar 113.188.10 euro ose 70.65% të shumës së alokuar.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas kursimeve	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4=3/2*100
1	SHPENZIME KOMUNALE	160.200.00	160.200.00	113.188.10	70.65

Në tabelën e poshtë shënuar, në mënyrë analitike, janë pasqyruar shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Nr	Përshkrimi	Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2018	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
1	2	3	4	5	6=5/4*100
1.	Energjia elektrike	70.000.00	70.000.00	39.463.87	56.37
2.	Shpenzimet e ujit	10.500.00	10.500.00	3.845.94	36.62
3.	Mbeturina	10.000.00	10.000.00	7.192.00	71.92
4.	PTK	6.500.00	6.500.00	6.622.47	101.88
5.	Ngrohja qendrore	63.200.00	63.200.00	56.063.82	88.70
6	Totali	160.200.00	160.200.00	113.188.10	70.65

4.4. SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Planifikimi i mjeteve buxhetore për kategorinë e subvencioneve në shumë prej 30.000.00 euro është bërë për t'i stimuluar studentët për lirim nga pagesat, të bazuara sipas rregulloreve për shërbimet e ofruara, si dhe stimulimin e studentëve të dalluar duke i shpërblyer me bursa të ndara nga UMIB-i.

Bazuar në planifikim dhe zotim të mjeteve, Këshilli Drejtues sjellë vendim që të shpallet konkursi për stimulimin e studentëve të dalluar. Shuma e bursave është përcaktuar nga numri i studentëve të cilët i kanë plotësuar kriteret e definuar.

Bazuar në kriteret e përcaktuara dhe shumës e planifikuar janë shpërndarë gjithsej 55 bursa në shumë prej 29.999.75 euro. Lartësia e bursave për student ishte 545.45 euro.

Për periudhën raportuese indeksi i realizimit të mjeteve të alokuara është 100% .

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Realizimi për janar/shtator/2018	mbetja	indeksi
		1	2	3	4=2-3	5=3:2*100
1	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	30.000.00	30.000.00	29.999.75	0.25	100

4.5 INVESTIMET KAPITALE

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për këtë vit fiskal, për investime kapitale janë planifikuar mjete në shumë prej 301.500.00 euro që në krahasim me vitin 2017 masa buxhetore është zvogëluar për 298.500.00 ose me indeks prej 50.25% .Mjetet janë planifikuar për furnizim me mjete/pajisje laboratorike për njësitë akademike në shumë prej 241.500.00 euro, 30.000.00 për teknologji informative dhe 30.000.00 për ndërtim të infrastrukturës së objekteve.

Pasqyrë e investimeve kapitale të strukturuar sipas projekteve të planifikuara për njësi akademike.

nr	Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Shuma e planifikuara.
1	1	2	3
2	14040	Ndërtimi i infrastrukturës në UMIB	30.000.00
3.	15258	Furnizim me pajisje për F.I.M.K.	100.000.00
4.	15259	Furnizimi me pajisje për F.T.U.	81.500.00
5.	15260	Furnizimi me pajisje për F.GJ.	60.000.00
6.	15261	Furnizimi me pajisje të T.I.	30.000.00
7.	Gjithsej.		301.500.00

Pasqyrë e planifikimit, alokimit, zotimit të mjeteve

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit	Alokimi mjeteve	Zotimi i mjeteve	Indeksi i angazhimit të mjeteve buxhetore
1.		1	2	3	3
	Investime kapitale	301.500.00	301.500.00	301.500.00	100

Për periudhën raportuese buxheti i dedikuar për këtë kategori është alokuar në shumë prej 301.500.00 euro. Mjetet e planifikuara janë zotuar sipas projekteve të aprovuara në shumë prej 301.500.00 euro. Për shkak procedurave të tej zgjatura të prokurimit, problemeve të natyrës së furnizimit të operatorëve me pajisje të kontraktuara si dhe vendimeve të Organit për Shqyrtim Publik OSHP, investimet e planifikuara janë realizuar në shumë prej 117.827.37 ose me indeks prej 54.46%.

Bazuar në kërkesën e MF dhe MASHT, organizata buxhetore me nën programe e tyre janë obliguar që bazuar në specifikat dhe analizën e realizimit të buxhetit të dedikuar, të paraqesin kursimet eventuale për investime kapitale. UMIB në bashkëveprim me zyrën e prokurimit për shkak të specifikave të lartë cekura ka proceduar kërkesën për kursim të mjeteve në shumë prej 183.672.23 euro. Qeveria ka shqyrtuar kërkesën për kursime duke aprovuar shumën prej 85.065.00 euro. Prandaj buxheti final pas aprovimit të vendimit të Qeverisë ishte 216.319.30 euro.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti final për investime kapitale	Alokimi mjeteve	Investimet realizuara për vitin fiskal 2018	Mjete mbetura	Indeksi realizimit
		1	2	3	4	5=3/2*100
1	INVESTIME KAPITALE	216.319.30	216.319.30	117.827.37	98.607.23	54.46


Pasqyra lidhur me strukturën e projekteve, buxhetin, ndryshimet, alokimet, zotimet, realizimi dhe ndryshimet/kursimi i mjeteve për investime kapitale (harmonizimi me fre balance 135.70 euro).

nr	Emërimi i projekteveve	Buxheti i aprovuar në janar 2018	Shkurtimet / kursimet buxhetore për 2018	Buxheti final për vitin fiskal 2018
		1	2	3
1	<i>Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës</i>	<i>30.000.00</i>		<i>30.000.00</i>
2	<i>Furnizimi me pajisje për FIMK</i>	<i>100.000.00</i>		<i>99.879.30</i>
3	<i>Furnizimi me pajisje për FTU</i>	<i>81.500.00</i>	<i>81.500.00</i>	
4	<i>Furnizimi me pajisje për FGJ</i>	<i>60.000.00</i>	<i>2.711.00</i>	<i>57.294.00</i>
5	<i>Furnizimi me pajisje për IT</i>	<i>30.000.00</i>	<i>854.00</i>	<i>29.146.00</i>
6	TOTALI	301.500.00	85.065.00	216.319.30

Zyra për buxhet dhe financa në bashkëveprim me njësitë akademike, menaxhmentin dhe zyrën për prokurim bazuar në fondin, alokimet, zotimet, realizim dhe kursimet ka zhvilluar aktivitete në përmbushjen e të gjitha përgjegjësiave që dalin nga fusha e menaxhimit të financave publike.

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar aktivitetet lidhur me gjendjen e realizimit të investimeve kapitale.

n r	Kodi i projektit	Emërti i projektit	Shuma e planifikuar/buxheti 2018	zotimi i mjeteve	Alokimi i mjeteve	Kontrata e lidhur me OP	Realizimi	Kursimi	Të pashfrytëzuara /mbetja	komente
1	2	3	4	5	6	7	8=4-5	9=4-(7+8)		
1	14040	Ndërtimi i infrastrukturës në parkun botanik. a.ndricimi i parkut b.ndërtimi i infrastuktues /vazhdim c.ndërtimi i emblemës	30.000.00 6.024.27 13.980.00 9.993.00	30.000.00	30.000.00	6.024.27 13.980.00 9.993.00	6.024.27 13.980.00 9.992.30		2.23	Projekti është realizuar në tërësi
2	15258	Furnizimi me pajisje për FIMK	100.000.00	100.000.00	100.000.00	98.885.00	1.395.00		98.605.00	Mosrespektimi i afateve për furnizim sipas kontratës bëri që mjetet mos të angazhohen. Furnizimi dhe realizimi i projektit është prolonguar për 2019
3	15259	Furnizimi me pajisje për FTU	81.500.00	81.500.00				81.500.00		Mjetet te planifikuara për shkak të vendimit të OSHP për anulim të prokurimit nuk janë realizuar për këtë arsye menaxhmenti i karakterizoi si të mjete të kursyera
4	15260	Furnizimi me pajisje për FGJ	60.000.00	60.000.00	57.289.00	57.289.80	57.289.00	2.711.00		Projekti është realizuar sipas kontratës,mbetja është karakterizuar si mjete të kursyera
5	15261	Furnizimi me pajisje për TI	30.000.00	30.000.00	29.146.00	29.146.00	29.146.00	854.00		Projekti është realizuar sipas kontratës,mbetja është karakterizuar si mjete të kursyera
6		gjithsej	301.500.00	301.500.00	216.319.30	185.329.00	117.827.37	85.065.00	98.607.23	Harmonizimi sipas free balance 135.30



5. TË HYRAT VETANAKE

Bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e dala nga Ligji mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës dhe udhëzimit administrativ të MASHT-it nr. 17/2014 për përcaktim të lartësisë së tarifave për ofrim të shërbimeve për studentë, për periudhën raportuese janë inkasuar 109.744.50 euro (niveli Bachelor dhe Master). Mjetet e grumbulluara sipas Ligjit mbi ndarjen Buxhetore për vitin 2018 janë shpenzuar vetëm për përmbushjen e obligimeve për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje. Të hyrat vetanake të realizuar nuk mund të shpenzohen për qëllim tjera dhe për nënkode të kategorive tjera ekonomike.

Për periudhën raportuese në emër të hyrave vetanake janë planifikuar të grumbullohen 114.661.00 euro, janë realizuar 109.744.50 euro ose me indeks prej 95.71 %. Të hyrat e realizuara janë për 4.950.50 më të ulëta se të hyrat e planifikuara për vitin 2018 gjegjësisht më të ulëta 13.599.50 se të hyrat e realizuar për vitin 2017 (123.374.00).

Pasqyra e planifikimit, bartjes së mjeteve, alokimit dhe realizimit të të hyrave vetanake.

Nr .	TË HYRAT VETANAKE	Bartja e të hyrave nga viti 2016	Planifikimi i të hyrave vetanake	Realizimi i të hyrave vetanake	alokimi	Të hyrat e shpenzuara	Mbetja e të hyrave/bartja në vitin 2018
		1	2	3	4	5	6=(3+1)-5
1		49.510.50 euro	114.661.00	109.744.50	100.015.00	120.256.50	38.988.50

Të hyrat e shpenzuara janë 120.256.50 me këtë strukturë: 49.510.50 nga të hyrat e bartura të vitit 2017 dhe 70.746.00 nga të hyrat e realizuara për vitin 2018.

Zyra për buxhet dhe financa bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues për lirim të studentëve për shërbimet për regjistrim të vitit akademik ka bërë kthimin e mjeteve për studentët të cilët kanë plotësuar kriteret e përcaktuara. Shuma e mjeteve të kthyer është 6.100.00 euro.

Pasqyrë e mjeteve të kthyer për studentë të strukturuar sipas kategorive të përcaktuara në vendim.

Nr.	KATEGORIJA	Niveli bachelor		Niveli master		totali	komente
		1	2	3	4		
		Nr.stud entëve	shuma	Nr.stud entëve	shuma		Çmimi për studime bachelor 25 master 150.00
1.	Dy apo më shumë student në familje	60	1.500.00	19	2.850.00	4.350.00	
2.	Student –fëmijë të dëshmorëve /vetaran	16	450.00	3	450.00	900.00	Në nivel bachelor një student ka paguar 2 herë
3.	Student me gjendje të vështirë sociale	15	400.00	3	450.00	850.00	Në nivel bachelor një student ka paguar 2 herë
4.	totali	91	2.350.00	25	3.750.00	6.100.00	